

**BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE NË**

# **BALLKANIN PERËNDIMOR**



**Banka  
Evropiane e  
Investimeve**

*Banka e BE*



**Lilyana Pavlova**  
Zëvendëspresidente

Në vitin 2020, një nga vitet më sfiduese të kohëve të fundit, Grupi i Bankës Evropiane të Investimeve forcoi rolin e tij si një nga investitorët dhe partnerët kryesorë të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Për shkak të pandemisë COVID-19, ndryshimet masive në shpërndarjen dhe zinxhirët e prodhimit çuan në pasoja të mëdha ekonomike, pasi shoqëritë tregtare hasën vështirësi financiare për të vijuar biznesin dhe për të ruajtur vendet e punës. Qeveritë vendase përdorën masa të jashtëzakonshme dhe paketa lehtësimi për të mbajtur gjallë industrinë.

Banka Evropiane e Investimeve (BEI) doli me sukses me një paketë financiare të menjëhershme për Ballkanin Perëndimor kur filloi pandemia. Së bashku me institucionet e tjera të BE-së që veprojnë së bashku si "Team Europe", BEI-ja miratoi një program financiar me vlerë 1,7 miliardë euro për t'iu përgjigjur krizës, e shoqëruar nga masa të jashtëzakonshme për të përshpejtuar lëvrimin e kredive të reja dhe ekzistuese.

Grupi i BEI-së mobilizoi mbështetje të gjerë financiare për rajonin për të lehtësuar pasojat e pandemisë dhe për të parandaluar 'rënien' e sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe sektorit privat. Banka gjithashtu shtriu mbështetjen e saj në infrastrukturën jetësore për të rritur qëndrueshmërinë si përgatitje për emergjencat e ardhshme.

Grupi i BEI-së zhbllkoi 320 milion euro për linjat e reja të kreditit që do të lehtësohen nga bankat tregtare vendase me kushte të favorshme dhe fleksibël kundër ndikimit të pandemisë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Në një kohë kur bizneset e vogla në të gjithë rajonin po përballeshin me kufizime të likuiditetit dhe po luftonin për të aksesuar fonde në mënyrë që të ruajnë operacionet e përditshme dhe vendet e punës, Grupi i BEI-së miratoi financimin për të përshpejtuar rimëkëmbjen e tyre dhe për t'i ndihmuar ata të mbajnë stafin e tyre në punë. Janë ruajtur mbi 37 000 vende pune falë financimit të BEI-së. Në mbështetje të punësimit gjithëpërfshirës, BEI-ja nënshkroi huanë e parë me ndikim në rajon. Kredia e synuar për NVM-të nxit punësimin afatgjatë të njerëzve nga grupet e cenueshme.

Ne jemi të kënaqur të shohim që Komisioni Evropian ka miratuar Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor në mbështetje të rimëkëmbjes ekonomike dhe integritet të rajonit në Bashkimin Evropian. Plani ofron projeksionin për një rajon më të gjelbër dhe më të begatë, me klimë më të përshtatshme për investime dhe treg pune më gjithëpërfshirës. Ai përcakton një paketë të konsiderueshme investimesh që mobilizon fonde me vlerë deri në 9 miliardë euro për transportin, energjinë dhe tranzicionin e gjelbër dhe digjital.

Si banka e BE-së për klimën, BEI-ja mbështet tranzicionin e gjelbër në rajon. Nismat që ajo financon do të ndihmojnë në zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe përshpejtojnë kalimin në energji pa gjenerim karboni në Ballkanin Perëndimor. Me sytë nga e ardhmja, krijimi i një rajoni të lidhur mirë, të gjelbër dhe gjithëpërfshirës do të sigurojë konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e tij pas COVID-19. Gjatë udhës, BEI-ja do të vijojë të mbështesë tranzicionin e gjelbër dhe digjital të rajonit si dhe integrimin e tij në tregun e BE-së.

# BEI-JA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

BEI-ja ofron shërbime financiare, kombinimesh dhe këshilluese në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë\*, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi

## VENDET KANDIDATE

Shqipëria  
Mali i Zi  
Maqedonia e Veriut  
Serbia

## VENDET KANDIDATE POTENCIALE

Bosnja dhe Hercegovina  
Kosova\*

PBB-ja gjithsej  
**98,2 miliardë euro**

Popullsia  
**17,5 milion**

Sipërfaqja  
**218 550 km<sup>2</sup>**

## NËNSHKRIMET E REJA NË RAJON NË VITIN 2020

€873 milionë euro

## FINANCIIMI I PËRGJITHSHËM QË PREJ VITIT 2009

€8,6 miliardë euro



\* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës

# HYRJE

**B**anka Evropiane e Investimeve është një nga financuesit kryesorë ndërkombëtarë në Ballkanin Perëndimor. Ne financojmë projekte që inkurajojnë rritjen përfshirëse dhe punësimin, modernizimin e infrastrukturës jetësore, lidhjen rajonale dhe tranzicionin e gjelbër dhe digjital. Nga viti 2009 deri më sot, BEI-ja ka investuar 8,6 miliardë euro në rajon.

Vetëm në vitin 2020, ne nënshkruam kredi dhe grante me vlerë 873 milion euro, duke rritur financimin tonë në rajon me 50% krahasuar me vitin 2019.

COVID-19 e goditi rajonin ashtu siç ai po përjetonte një rritje të aktivitetit ekonomik<sup>1</sup>. Rritja u kufizua nga pandemia, megjithatë, produkti i brendshëm bruto (PBB) gjithashtu u tkurr me një mesatare prej 3,4%, me ulje që varion nga -1% në Serbi në -15% në Malin e Zi. Bllokimet, mbylljet e kufijve dhe kufizimet e tjera goditën rëndë shërbimet intensive të punës, veçanërisht industrinë e shitjes me pakicë dhe turizmit. Sidoqoftë, në vitin 2021 pritet një rimëkëmbje e qëndrueshme, ku Fondi Monetar Ndërkombëtar parashikon rritje të PBB-së me 4,8%.

## Paketa me vlerë prej **3.3 miliardë euro** e Team Europe:

- **41.5 milion euro** për pajisje mjekësore
- **88 milion euro** për sektorët e shëndetit dhe të ujit
- **761 milion euro** për rimëkëmbjen socio-ekonomike
- **750 milion euro** si asistencë makro-financiare
- **1.7 miliardë** investim i BEI-së

BEI-ja luan një rol kryesor në përgjigjen e 'Team Europe' të BE-së ndaj krizës së COVID-19, ku ajo ka kontribuar një vlerë prej 1,7 miliardë eurosh nga paketa me vlerë totale prej 3,3 miliardë eurosh, e cila u shpall në Samitin e Zagrebit për Ballkanin Perëndimor në maj të vitit 2020. Team Europe mbështet përpjekjet e vendeve partnere për të trajtuar pandeminë, duke kombinuar burimet nga Bashkimi Evropian, shtetet anëtare të tij dhe institucionet financiare evropiane.

Deri më tani, Banka ka mobilizuar mbi 1 miliardë euro për të përshpejtuar rimëkëmbjen e Ballkanit Perëndimor nga pandemia. Fondet ofruan lehtësim të menjëhershëm për sektorin e kujdesit shëndetësor dhe sektorin privat, veçanërisht shoqëritë e vogla tregtare, të cilat u goditën më rëndë.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përbëjnë 99% të të gjitha ndërmarrjeve dhe zënë 72% të punësimit total në Ballkanin Perëndimor. Sidoqoftë, 32% e NVM-ve që kanë nevojë për kredi ndeshen me kufizime financiare<sup>2</sup>, e cila është arsyeja pse vlera prej 400 milion eurosh nga mbështetja e BEI-së për rimëkëmbje ndaj COVID-19 është caktuar posaçërisht për NVM-të dhe shoqëritë tregtare me kapital të mesëm.

Përveç mbështetjes së menjëhershme për rimëkëmbjen, Banka vazhdon të ndihmojë tranzicionin binjak të gjelbër dhe digjital të rajonit, një përparësi e Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor, të miratuar nga Komisioni Evropian në vitin 2020.

<sup>1</sup> Komisioni Evropian

<sup>2</sup> Sondazh për Ndërmarrjet i BEI-BERZH-Bankës Botërore

Plani Ekonomik dhe i Investimeve parashikon një paketë të konsiderueshme investimesh, duke mobilizuar fonde me vlerë deri në 9 miliardë euro për rajonin. Në përputhje me theksin e planit për rritjen e investimeve në sektorin privat, Instrumenti i Garancisë për Ballkanin Perëndimor pritet të katalizojë investime me vlerë deri në 20 miliardë euro, kryesisht në sektorin privat, duke nxitur zhvillimin dhe konkurrencën.

## ÇFARË OFROJMË

Në Ballkanin Perëndimor, BEI-ja ofron hua, grante dhe ekspertizë në katër fusha kryesore: inovacion, biznese të vogla, infrastrukturë dhe klimë.

Ne kombinojmë kredi me investime nga organizata të tjera, dhe ekspertët tonë këshillues sigurohen që projektet të zbatohen dhe të lulëzojnë.

### TRI SHTYLLA

#### HUADHËNIA

Ne përdorim fuqinë tonë financiare për të mbledhur para me norma të favorshme interesi. Ne i përdorim kursimet për të dhënë kredi për projekte me cilësi të lartë

#### KOMBINIMI

Duke punuar me partnerë të tillë si Komisioni Evropian, ne i ndihmojmë klientët të kombinojnë financimin tonë me investime nga burime të tjera

#### SHËRBIME KËSHILLIMORE

Ne ofrojmë një paketë të larmishme asistence teknike për projekte të mëdha infrastrukturore në sektorin publik dhe një gamë të gjerë investimesh në sektorin privat



**Huadhënia e  
BEI-së për spitalet  
në Serbi në vlerën  
250 milion  
euro**

## **Pas 50 vjetësh, një spital i ri për Nishin**

Në vitet 1970, kishte plane të mëdha për një spital të ri, të teknologjisë së fundit Nish. Ndërtimi filloi, por pas shumë vonesash, projekti u braktis. Qendra Klinike në Nish ngeci për një gjysmë shekulli, derisa financimi i BEI-së ndihmoi në ndërtimin e institucionit më modern të kujdesit shëndetësor të Serbisë.


Spitali i ri është pjesë e një investimi prej 250 milion eurosh, i cili gjithashtu përfshin projektimin, ndërtimin, arredimin dhe pajisjet e qendrave klinike në Beograd, Novi Sad dhe Kragujevac, si dhe të 20 spitaleve të tjera në të gjithë vendin. Qëllimi është të përmirësojë kujdesin shëndetësor në të gjithë vendin dhe ta bëjë atë më të arritshëm për shumicën e popullsisë.

Qendra e re klinike në Nish u shërben rreth 2,5 milion njerëzve në Serbinë jug-lindore. Para hapjes së qendrës, pacientët shpesh dërgoheshin në spitalin e Beogradit, që ndodhet 200 km larg. «Listat e pritjes janë zvogëluar,» tha Dr Milan Simić, radiolog i qendrës. «Nuk na duhet të shkojmë më në Beograd.»

# HUADHËNIA

Huadhënia është aktiviteti ynë kryesor. Ne mbështesim projekte që ndihmojnë dukshëm rritjen, punësimin, kohezionin rajonal dhe qëndrueshmërinë.

## OPERACIONET E BEI-SË TË NËNSHKRUARA NË BALLKANIN PERËNDIMOR (2009-2020)



Burimet: Përlogaritje e stafit të BEI-së bazuar në bazën e të dhënave të WIW dhe Zyrate Kombëtare të Statistikave

## MBËSHTETJE PËR RIMËKËMBJEN NGA COVID-19


Banka Evropiane e Investimeve po mbështet rimëkëmbjen pas pandemisë në Ballkanin Perëndimor me 1,7 miliardë euro. Paketa është pjesë e mbështetjes financiare të 'Team Europe' për rimëkëmbjen ekonomike të rajonit. Përfituesit kryesorë do të jenë ata që janë goditur më së shumti nga kriza - sektori i kujdesit shëndetësor dhe bizneset e vogla.

Së bashku me këtë asistencë financiare, BEI-ja miratoi masa të jashtëzakonshme në lidhje me pandeminë për të siguruar që fondet për operacionet e reja dhe ato ekzistuese të lëvrohen më shpejt. Masat emergjente të vendosura përfshinin kritere më të gjera të pranueshmërisë, afate më të shkurtra kredie dhe lëvrimet të përshpejtuara, për t'iu përgjigjur nevojave të bizneseve të vogla dhe për t'i ndihmuar ata të rimarrin veten.

Përveç mbështetjes së menjëhershme dhe afatshkurtër, banka e BE-së po ndihmon secilin vend të modernizojë infrastrukturën e tij, të forcojë sektorin e tij privat dhe ta bëjë atë më të përgatitur për krizat e ardhshme.

Me investimin e një vlere prej 365 milion eurosh në infrastrukturën e kujdesit shëndetësor në Ballkanin Perëndimor deri më sot, Banka Evropiane e Investimeve ka kontribuar në një gatishmëri më të madhe për pandeminë dhe akses në kujdes më të mirë mjekësor për pesë milion njerëz.

Kujdes më i mirë  
shëndetësor  
për **5 milion**  
njerëz



**Huadhënia  
e BEI-së  
për rehabilitimin  
hekurudhor  
20 milion  
euro**

**Një prej linjave hekurudhore më të bukura të  
Evropës i rikthehet shkëlqimit të dikurshëm**

BEI-ja po punon për të rijetëzuar rrugët hekurudhore në të gjithë rajonin. Hekurudhat ofrojnë një zgjidhje më të qëndrueshme sesa rrugët për një rajon që kërkon të zvogëlojë emetimet e gazeve serë dhe të përmirësojë sigurinë rrugore.

Hekurudha e Malit të Zi ishte dikur një nga arritjet e saj më të jashtëzakonshme, duke i transportuar pasagjerët në një nga udhëtimet më të bukura në Evropë, nga kryeqyteti i Serbisë, Beogradi në portin kryesor detar të Malit të Zi, Tivari. Por mungesa e vazhdueshme e financimit e ka lënë atë me probleme të mëdha. Udhëtimi që dikur zgjaste 7 orë, tashmë pothuaj 11 orë. Me ndihmën tonë, planifikohet që hekurudha të rijetëzohet. Ne kemi miratuar një kredi prej 20 milionë eurosh për të rehabilituar linjën hekurudhore nga Tivari në Vërbnicë, në kufirin me Serbinë.

Përveç krijimit të 1 000 vendeve të punës në Malin e Zi gjatë riparimeve, projekti do të përmirësojë lidhjet tregtare kryesisht me Serbinë dhe Rumaninë, dhe do të promovojë edhe turizmin.



## TRANSPORT MË I SIGURT DHE I QËNDRUESHËM

Gjatë pranisë tonë 40-vjeçare në Ballkanin Perëndimor, ne kemi ndërtuar qindra kilometra rrugë më të sigurta, duke krijuar lidhje më të mira rajonale, tregti më të shpejtë, zhvillim ekonomik dhe mundësi të reja pune.

Një nga projektet më ambicioze mbetet seksioni boshnjak i Korridorit Vc, i financuar nga Banka Evropiane e Investimeve me mbi 1 miliard euro deri më sot. Ky korridor i rëndësishëm pan-evropian do të lidhë Bosnjën dhe Hercegovinën me Hungarinë, Kroacinë lindore dhe Detin Adriatik, si dhe do të shkurtojë udhëtimet për 1,5 milion njerëz.

**“Investimi i BEI-së do të ndihmojë të jemi më pranë objektivit të Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor: 75% e Korridorit Vc e përfunduar deri në vitin 2024.”**

*Ambasadori Johann Sattler, kreu i Delegacionit të BE-së dhe Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë*

Një projekt tjetër me përparësi është Autostrada e Paqes, në të cilën kemi kontribuar 100 milion euro (të mbështetur nga një grant prej 48 milion eurosh nga BE-ja). Autostrada lidh Beogradin me Bregun Adriatik të Shqipërisë dhe synon të rrisë bashkëpunimin dhe tregtinë në Ballkanin Perëndimor.

## TRANZICION I GJELBËR

Pandemia COVID-19 nuk është e vetmja emergjencë me të cilën përballlemi. Ndryshimet klimatike janë kërcënim i madh për vetë ekzistencën tonë. Si bankë e BE-së për klimën, Banka Evropiane e Investimeve është e përkushtuar të harmonizojë të gjitha aktivitetet e saj me qëllimet e Marrëveshjes së Parisit dhe ta bëjë Evropën kontinentin e parë neutral ndaj klimës deri në vitin 2050. Ne kemi vendosur një synim ambicioz për të angazhuar 50% të financimit tonë për klimën deri në vitin 2025 dhe për të mobilizuar deri në 1 trilionë euro për veprimet klimatike dhe projektet e qëndrueshmërisë mjedisore deri në vitin 2030.

**“Lufta kundër ndryshimeve klimatike nuk mund të presë derisa të mbarojë pandemia. Kriza e COVID nuk është arsye për të ndaluar luftën ndaj klimës dhe sfidave mjedisore me të cilat përballlet njerëzimi. Ne kemi nevojë për investime masive për rimëkëmbje të gjelbër.”**

*Presidenti i BEI-së, Werner Hoyer*

Ballkani Perëndimor ka kohë që lufton me pasojat e ndryshimeve klimatike. Reshje masive shiu dhe përmytje kanë goditur Bosnjën dhe Hercegovinën, Serbinë dhe Malin e Zi gjatë dekadës së fundit. BEI-ja qëndroi përkrah rajonit, duke siguruar lehtësim të menjëhershëm financiar dhe mbështetje për parandalimin e katastrofave.

Një çështje tjetër me një ndikim të madh në shëndetin e njerëzve në të gjithë rajonin është ndotja e ajrit dhe ujit, e cila është ndër nivelet më të larta në Evropë. BEI-ja ka në plan të mbështesë tranzicionin e gjelbër dhe futjen e burimeve më efikase, të ripërtërishme dhe më të pastra të energjisë me gjurmë më të ulët të karbonit.

Ne po investojmë në objektet vendase dhe rajonale të trajtimit të ujërave të ndotura. Në Beograd dhe qytete të tjera të mëdha serbe, ka projekte në zhvillim. Ne kemi ofruar edhe 11 milion euro për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në komunën e Gjilanit, e cila do t'i shërbejë mbi 90 000 qytetarëve në Kosovë\*.

Shërbime më të  
mira të ujërave të zeza  
për **90 000**  
qytetarë  
në Kosovë\*



Deri në fund të vitit 2021, mbi **1800** shkolla më të mëdha do të mbulohen plotësisht **me internet me shpejtësi të lartë pa tel**, ndërsa shkollat e mbetura në zonat e thella do të lidhen duke përdorur njësi të lëvizshme me bandë të gjerë.

## DIGJITALIZIMI

Pandemia COVID-19 është një kujtesë për domosdoshmërinë e teknologjisë digjitale në një sërë sektorësh, duke filluar nga shëndetësia te shitja me pakicë, prodhimi dhe arsimit.

Ndikimi i pandemisë në arsim ka qenë i madh, me mbylljet e shkollave dhe universiteteve që prekën mbi 90% të popullsisë globale studentore në 194 vende. Kriza ekspozoi ndarjen digjitale midis dhe brenda vendeve, duke e bërë të qartë nevojën globale për transformimin digjital të sektorit të arsimit. Banka Evropiane e Investimeve po ndihmon shkollat serbe të përgatiten për epokën digjitale.

**“COVID-19 e ka detyruar të gjithë botën të bëhet digjitale. Zotërimi i aftësive digjitale është bërë më vendimtar se kurrë për të mësuarin, punën dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri.”**

*Sem Fabrizi, Ambasador i BE-së dhe shef i Delegacionit të BE-së në Serbi*

Ne kemi dhënë 65 milion euro për digjitalizimin e mbi 1 800 shkollave në Serbi, duke mundësuar futjen e rrjeteve me brez të gjerë, pajisje TIK, platforma mësimore në internet dhe trajnime digjitale për më shumë se 50 000 mësues. Projekti do të rrisë kapacitetin e mësuesve për të dhënë mësim në internet në mënyrë më efektive, ndërsa nxënësit në të gjithë vendin do të jenë në gjendje të kenë akses në arsimin digjital.

## INOVACION

Banka Evropiane e Investimeve është në krye të inovacionit, duke filluar nga zgjidhjet për ndryshimet klimatike tek zhvillimi i vaksinave. Në dy dekadat e fundit, BEI-ja ka investuar 210 miliardë euro në mbështetjen e teknologjisë më të fundit.

Vetëm në Serbi, ne kemi investuar 200 milion euro në kërkim dhe zhvillim. Financimi ynë ka ndihmuar në ndërtimin e tre parqeve shkencore dhe teknologjike, të cilat shërbejnë si parajsë të sigurta për sipërmarrjet e reja dhe të shumta serbe, në Nish, Beograd dhe Novi Sad. Ky investim ka ndihmuar në krijimin e kushteve më të mira të punës për studentët, shkencëtarët dhe sipërmarrësit inovativë të cilët tani janë në gjendje të zhvillojnë idetë e tyre në vendin e tyre.

Huadhënia e  
BEI-së për  
digjitalizim në  
vitin 2020 në vlerë  
**65 milion  
euro**

Huadhënia e BEI-së  
për inovacion  
**200 milion  
euro**



*“Shumë njerëz emigrojnë nga rajoni ynë. Por, unë vendosa të qëndroj dhe të vazhdoj të drejtoj biznesin e familjes sime. Dhe kur na duhej financim, ndërhyri Banka Evropiane e Investimeve.”*

**Tomislav Puđa, pronar dhe drejtor i shoqërisë tregtare të prodhimit të produkteve të bulmetit Eko sir Puđa.**

## BIZNESET E VOGLA

Që prej vitit 2008, BEI-ja ka investuar mbi 4,5 miliardë euro në bizneset e vogla në Ballkanin Perëndimor, duke u bërë kështu huadhënësi kryesor ndërkombëtar për NVM-të në rajon.

Atëherë, si funksionon ky investim? Grupi i BEI-së, i cili përfshin vartësin tonë të specializuar për bizneset e vogla, Fondin Evropian të Investimeve (FEI), ofron një sërë instrumentesh financimi për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vendet e Ballkanit Perëndimor. BEI-ja u jep kredi bankave vendore dhe ndërmjetësve të tjerë, të cilët më pas u japin kredi bizneseve të mesme dhe të vogla. FEI-ja është i specializuar, për pjesën e tij, në financimit e riskut për bizneset e vogla. Ndër të tjera, ai jep garanci për ndërmjetësit me synimin e nxitjes së huadhënies ndaj firmave të vogla.

Në Ballkanin Perëndimor, FEI-ja ka pasur një prezencë të qëndrueshme që prej vitit 2012, kur u krijua Instrumenti për Sipërmarrje dhe Inovacion në Ballkanin Perëndimor për të përmirësuar aksesin e shoqërive të vogla tregtare në financim. Sipas këtij instrumenti, FEI-ja vepron si garanci që u ofron mbrojtje kundër humbjeve ndërmjetësve financiarë për humbjet që kanë ndodhur në portofola të përzgjedhur.

Investimet tona deri më tani kanë arritur tek 28 400 shoqëri tregtare në rajon dhe kanë ndihmuar në ruajtjen e 500 000 vendeve pune, e cila është një përparësi për Grupin e BEI-së, veçanërisht në kohën e pasojave ekonomike të shkaktuara nga COVID-19. Janë ruajtur mbi 37 000 vende pune falë financimit të BEI-së.

Për të zbutur goditjen e pandemisë mbi likuiditetin e bizneseve të vogla, BEI-ja po jep financim afatshkurtër për të ndihmuar shoqëritë tregtare të plotësojnë nevojat e tyre më urgjente. Fondet kanalizohen përmes grupeve më të mëdha bankare ndërkombëtare në rajon si: Intesa, Unicredit, Raiffeisen, Erste, OTP, Credit Agricole. Banka dhe Grupi i ProCredit gjithashtu ranë dakord për një linjë të re kredie me vlerë 65 milion euro për të adresuar kapitalin qarkullues, likuiditetin dhe nevojat për investime të bizneseve të vogla në Serbi, Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.

BEI-ja po rrit gjithashtu përpjekjet për të ndihmuar bizneset e sektorëve më të prekur, duke i dhënë Fondit të Investimeve dhe Zhvillimit të Malit të Zi një vlerë prej 50 milion eurosh për të mbështetur bizneset e vogla që veprojnë në turizëm dhe industri të tjera të prekura rëndë nga COVID-19. Ky financim është i rëndësishëm sidomos për faktin që të ardhurat nga turizmi zënë mbi 20% të PBB-së së Malit të Zi.

Adresimi i probleme me të ardhurat është thelbësor, por bizneset e vogla duhet gjithashtu që të rrisin përpjekjet për transformimin e tyre digjital. Fondi Evropian i Investimeve nënshkroi një marrëveshje me vlerë 60 milion euro në Serbi, e para në kuadrin e garancisë së digjitalizimit të Komisionit Evropian, COSME (Konkurrenca e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme), për të ndihmuar shoqëritë e vogla tregtare që dëshirojnë të financojnë planet e tyre të zhvillimit të biznesit dhe transformimin digjital .

BEI-ja nënshkroi gjithashtu huanë e parë të financimit të ndikimit (15 milion euro) me UniCredit Bank për të ndihmuar bizneset e vogla serbe të përmirësojnë ndikimin e tyre social në drejtim të barazisë gjinore, punësimit të të rinjve dhe përfshirjes sociale të grupeve të tilla si minoritetet, personat me aftësi të kufizuara, refugjatët dhe njerëzit e zhvendosur brenda vendit. Aktualisht, në të gjithë rajonin po përgatiten operacione të reja të financimit të ndikimit.

**Projekti i parë i zhvillimit urban i BEI-së në Ballkanin Perëndimor do të pastrojë Lumin e Lanës dhe do të përmirësojë rrugët dhe infrastrukturën urbane të kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranës.**




# NISMA PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE

**B**anka Evropiane e Investimeve ka rritur përkrahjen e vet për fqinjësinë e Bashkimit Evropian, sidomos fqinjësinë me vendet jugore dhe me vendet e Ballkanit Perëndimor, në drejtim të rritjes ekonomike dhe realizimit të qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm. Nevojitet përkrahje shtesë pas krizës së migracionit, e cila ka krijuar më shumë sfida zhvillimore në këto rajone dhe ka cenuar aftësinë rimëkëmbëse ekonomike të një sërë vendesh. Për t'i mbështetur këto ekonomi, duhet të azhurnohet dhe zhvillohet infrastruktura sociale dhe ekonomike dhe të stimulohet rritja e sektorit privat dhe krijimi i vendeve të punës.

Deri më tani, janë miratuar 60 projekte në këto dy rajone, që përbëjnë investime në vlerën totale prej 5,83 miliardë eurosh. Ne po shqyrtojmë se si të bazohemi në mësimet e Nismës së Rimëkëmbjes Ekonomike, për të përsëritur sukseset e saj, për të zgjeruar përgjegjësinë e saj dhe për t'u përqendruar në faktorët kryesorë të migrimit dhe zhvendosjes së detyruar, të tilla si ndryshimet klimatike dhe brishtësia.

## Nisma për Rimëkëmbjen Ekonomike e Bankës Evropiane të Investimeve

**5,83 miliardë euro hua të reja që nga viti 2016**



An aerial photograph of a wastewater treatment plant. The image shows several large, circular, green-colored tanks arranged in a radial pattern. In the center, there is a prominent blue metal structure, likely a central aeration or filtration unit. The water in the tanks appears to be a light brown or tan color. The overall scene is brightly lit, suggesting a sunny day.

BEI-ja ka dhënë **11 milion euro** për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në Gjilan, e cila do t'u shërbejë më shumë se **90 000** njerëzve në Kosovë\*. Projektet do të përfitojë nga një grant prej **3,1 milion euro** në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor për mbështetje në përgatitjen dhe zbatimin e projektit.



# KOMBINIMI

## KORNIZA E INVESTIMEVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

BEI-ja punon me shumë partnerë në Ballkanin Perëndimor për të ofruar një sërë investimesh.

Në vitin 2008, Këshilli i Çështjeve Ekonomike dhe Financiare kërkoi një Kornizë gjithëpërfshirëse të Investimeve në Ballkanin Perëndimor për të përmirësuar harmonizimin dhe bashkëpunimin në investime për zhvillimin socio-ekonomik të rajonit.

Korniza filloi në dhjetor të vitit 2009, si nismë e përbashkët e Komisionit Evropian, Bankës Evropiane për Investime, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankës për Zhvillim e Këshillit të Evropës. Ajo u krijua si përgjigje ndaj kërkesës së vendeve të Ballkanit Perëndimor për të integruar kushtet për asistencën e ofruar nga donatorë të ndryshëm. Grupi i Bankës Botërore, banka gjermane për Zhvillim KfW dhe Agjencia Franceze për Zhvillim janë bërë pjesë e Kornizës.

Korniza është një strukturë bashkëpunimi të shumanshëm dhe të hollësishëm që ofron asistencë teknike dhe grante për projekte infrastrukturore në Ballkanin Perëndimor. Ajo mbështet projekte që përmirësojnë konkurrencën dhe rritjen, ndërsa forcojnë bashkëpunimin rajonal dhe lidhshmërinë. Sektorët që kualifikohen për mbështetje janë energjia, mjedisi, sektori social, transporti dhe sektori privat e infrastruktura digjitale. Korniza mbledh grante nga buxheti i BE-së, disa donatorë dypalësh dhe institucionet financiare partnere.

Korniza është identifikuar gjithashtu si mjeti kryesor për zbatimin e Planit ambicioz Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor.


Plani synon të nxisë rimëkëmbjen afatgjatë ekonomike të rajonit, të mbështesë tranzicionin e gjelbër dhe digjital, të nxisë integrimin rajonal dhe konvergjencën me Bashkimin Evropian.

**"Plani ofron një rrugë për integrimin e suksesshëm ekonomik të rajonit për të ndihmuar në mbylljen e hendekut të zhvillimit midis rajoneve tona, duke përshpejtuar përfundimisht procesin e integrimit në BE."**

*Olivér Várhelyi, Komisioner i BE-së për Fqinjësi dhe Zgjerim*

**123 MW**  
energji elektrike nga burimet e  
ripërtërishme **62** ndërtesa publike të  
rikonstruktura dhe mbi  
**500 000** ton CO2 të evituara në vit  
Ngrohja qendrore u përmirësua në  
**22** qytete dhe qyteza

Rezultatet e FIBP



## Pastrimi i Danubit, një hallkë kyçe në zinxhirin e transportit të Evropës

BEI-ja po ndihmon Serbinë të gjejë mënyrën më të mirë për të gjetur dhe hequr anijet e fundosura të Luftës së Dytë Botërore nga fundi i Danubit. Pastrimi i shtratit të lumit do ta bëjë lundrimin në këtë pjesë të lumit shumë më të sigurt dhe më të shpejtë, si dhe do të kursejë 5 milion euro në vit që Serbia i humb për shkak të rreziqeve të lundrimit.

Danubi është pjesë e një lidhje pan-evropiane dhe ky projekt do ta bëjë transportin e mallrave më të shpejtë dhe më efikas, duke kontribuar në ekonominë e Serbisë dhe duke e lidhur atë me pjesën tjetër të Evropës.



# SHËRBIME KËSHILLIMORE

## MBËSHTETJE PËR PROJEKTET E INFRASTRUKTURËS

Shërbimi këshillimor dhe i asistencës teknike i BEI-së mbështet përgatitjen dhe zbatimin e projekteve prioritare të infrastrukturës në sektorët e transportit, mjedisit, energjisë dhe sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Një ekip ekspertësh ndihmon me studime fizibiliteti, plane paraprake dhe të detajuara, procesin e tenderimit, mbikëqyrje të projekteve dhe studime të tjera përgatitore. Kjo mbështetje bashkëfinancohet nga Komisioni Evropian dhe BEI-ja dhe u ofrohet përfituesve falas.

Si menaxher i Instrumentit të Projekteve të Infrastrukturës, i financuar nga Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor, ne përdorim stafin tonë dhe këshilltarët e jashtëm për të ndihmuar organet e sektorit publik të rrisin mundësitë e tyre për të tërhequr investime për projektet e tyre.

Programi ynë i Qendrës Evropiane të Ekspertizës për PPP gjithashtu ndihmon vendet e Ballkanit Perëndimor për zhvillimin e Partneriteteve Publik-Privat (PPP), duke u ofruar këshilla lidhur me ligjet për PPP-në dhe duke ndarë përvojën dhe praktikat më të mira për t'i ndihmuar autoritetet publike të realizojnë partneritetet më të mira.

Dy instrumentet kryesore të ndihmës për mbështetje këshilluese, JASPERS dhe ELENA, gjithashtu veprojnë në Ballkanin Perëndimor.

JASPERS, që nënkupton Asistencën e Përbashkët për Mbështetjen e Projekteve në Rajonet Evropiane, ndihmon qytetet dhe rajonet të thithin fonde Evropiane përmes projekteve të një cilësie të lartë, duke arritur kështu kohezion më të madh në Evropë. Ai mundëson planifikimin, përgatitjen, prokurimin dhe menaxhimin e projekteve sipas standardeve më të larta teknike, sociale dhe mjedisore, në përputhje me politikat e BE-së.

ELENA nënkupton Asistencën Evropiane për Energji Lokale. Ai siguron asistencë teknike për investime me energji efikase dhe energji të ripërtërishme me vlerë mbi 30 milion euro, duke synuar ndërtesat dhe transportin e lëvizshmërinë novatore urbane.

## MBËSHTETJE KËSHILLIMORE NDAJ BIZNESEVE TË VOGLA

Instrumenti për Sipërmarrje dhe Inovacion në Ballkanin Perëndimor, i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe koordinohet nga Fondi Evropian i Investimeve, përmirëson qasjen në financim për shoqëritë tregtare të vogla në Ballkanin Perëndimor. Platforma ndërthur kreditë, kapitalin, garancitë, grantet stimuluese dhe asistencë teknike për të mbështetur rritjen e NVM-ve.

Platforma ka për qëllim të përmirësojë mjedisin e biznesit për firmat e vogla dhe të promovojë kërkimin, zhvillimin e inovacionin në rajon.

## RRETH NESH

BEI-ja është bankë e Bashkimit Evropian. Ne ofrojmë financim dhe ekspertizë për projekte të qëndrueshme investimesh. Në vitin 2020, Grupi i BEI-së ka dhënë 64 miliardë euro për investime afatgjata në të gjithë Evropën dhe në botë. Ekipi përgjegjës për Ballkanin Perëndimor ndodhet në selinë e BEI-së, në Luksemburg. Që prej vitit 2018, ne kemi shtuar staf në Shqipëri dhe Bosnje dhe Hercegovinë për të rritur praninë tonë vendase. Ekipi ynë për Ballkanin Perëndimor mbulon një gamë të gjerë projektesh dhe përfshin ekspertë drejtues me përvojë të madhe në rajon. Që prej vitit 2010, zyra jonë rajonale në Serbi ka menaxhuar marrëdhëniet institucionale në Ballkanin Perëndimor. FEI-ja është pjesë e Grupit të Bankës Evropiane të Investimeve. Misioni i saj është të mbështesë mikro, të vogël të Evropës dhe bizneset e mesme duke i ndihmuar ata të kenë akses në financa.



**Banka  
Evropiane e  
Investimeve**

*Banka e BE*

**Banka Evropiane e Investimeve**  
98-100, boulevard Konrad Adenauer  
L-2950 Luxembourg  
+352 437 91  
[www.eib.org](http://www.eib.org)

 [twitter.com/EIB](https://twitter.com/EIB)

 [facebook.com/EuropeanInvestmentBank](https://facebook.com/EuropeanInvestmentBank)

 [youtube.com/EIBtheEUBank](https://youtube.com/EIBtheEUBank)

### **Matteo Rivellini**

Shef i Divizionit, Operacionet e Huadhënies  
Ballkani Perëndimor, Slloveni dhe Kroaci  
+352 437 988 417  
[m.rivellini@eib.org](mailto:m.rivellini@eib.org)

### **Tibor Jona**

Kontakti me shtypin, zyrtar i lartë për shtypin  
+39 064 719 1  
[t.jona@eib.org](mailto:t.jona@eib.org), [press@eib.org](mailto:press@eib.org)  
Banka Evropiane e Investimeve  
98-100, Boulevard Konrad Adenauer  
L-2950 Luxembourg  
+352 437 91 -21000

### **Alessandro Bragonzi**

Përgjegjëse e Përfaqësisë Rajonale të BEI-së për Ballkanin  
Perëndimor  
Përfaqësia Rajonale për Ballkanin Perëndimor

Vladimira Popovića 38-40  
11070 Beograd  
+381 113 121 756  
[a.bragonzi@eib.org](mailto:a.bragonzi@eib.org)

### **Sandrine Friscia**

Përfaqësues i BEI-së për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Malin  
e Zi  
Delegacioni i Bashkimit Evropian në BH, Skenderija 3a  
71000 Sarajevo, Bosnjë dhe Hercegovinë  
+387 33 254 792  
[s.friscia@eib.org](mailto:s.friscia@eib.org)

Zyra e përfaqësuesit të BEI-së për Shqipërinë, Maqedoninë e  
Veriut dhe Kosovën\*

Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri  
ABA Business Centre, 17th floor  
Rruga Papa Gjon Pali II  
Tiranë, Shqipëri  
+352 437 983 066

E printuar në Maxi offset FSC® Mix.

BEI-ja përdor letër të certifikuar nga Këshilli i Mbikëqyrjes së Pyjeve (FSC). Sepse është bërë nga njerëz që i duan pemët. FSC-ja nxit menaxhimin e shëndoshë të pyjeve të botës në aspektin e mjedisit, me përfitime sociale dhe jetësore ekonomikisht.

Të gjithë e dimë se leximi është gjë e mirë për ju. I shërben për mirë edhe planetit – për sa kohë që lexoni në letërën e duhur.

Printuar nga Print Solutions

